

CIVIL

3FM



DORACAK GAZETARESİK



DORACAK GAZETARESK

PËRMBAJTJE

13

Kodeksi etik i
Asociacionit
Gazetaresk
të Norvegjisë

33

Kodeksi i
gazetarëve të
Maqedonisë

45

Tipet e
gazetarëve


Zhanret
gazetareske sipas
Dojçe Vele - DW

55

5 Në fillim

9 Gazetaria është...

29 Gazetari...



Në fillim

Gazetarët dhe gazetaria në Maqedoni po e humbin betejën – tashmë edhe krejtësisht të dukshme – me tentativat e pareshtura të pushtetit që fuqimisht t’i mbajë nën kontroll. Pikërisht kjo, si dhe ndarjet e imponuara në “patriotë” (tanët) dhe “tradhtarë” (të gjithë të tjerët) shkaktuan konflikte edhe ndërmjet gazetarëve, kurse gazetarinë e çuan në sindromin e vetëshkatërrimit.

Pushteti në mënyrë tejet arrogante merr guximin t’i radhisë dhe t’i ndajë mediumet dhe gazetarët në të përshtatshëm dhe të papërshtatshëm, duke uzurpuar jo vetëm lirinë e medias por edhe të drejtën themelore të njeriut për mendim personal.

Si pasojë e krizës në të cilën ra gazetaria në Maqedoni pothuajse përditë shkelen dhe devalvohen normat themelore të profesioni, parimet etike, kodeksi dhe praktikat e mirësjelljes.


Doracakun për gazetarë e hartoi OJQ Civil Media në bazë të përvojave dhe dokumenteve të Norvegjisë, Gjermanisë, Britanisë së Madhe dhe Maqedonisë. Ka për qëllim që gazetarët, redaktorët dhe të gjithë të pu-

nësuarit të tjerë t'i përkujtojë për rregullat kryesore dhe vlerat etike të profesionit.

Gazetaria në Norvegji, sipas etikës, profesionalizmit dhe rolit të saj në shoqëri, radhitet ndër më të mirat në Evropë. Pasqyra e zhanreve gazetareske u hartua në bazë të pëvojave të Dojçe Vele-s dhe shkollës gjermane të gazetarisë. Kaptina për integritetin dhe profesionalizmin e gazetarit u mor nga Medias Ideas Internacional nga Britania e Madhe.

Hartuesit u shprehin falënderime të gjithëve të cilët shprehën vullnet të mirë për ta ndihmuar hartimin e këtij doracaku.

Shkup, Gusht 2011




Gazetaria është...

**...gjurmim i
përditshëm pas
së vërtetës, luftë
e pafund për
drejtës
drejta.**




**...zgjerim i vazhdueshëm i kufijve
të lirive dhe të drejtave të njeriut,
pushtim i hapësirave të reja të
demokracisë, promovim i vlerave
më të larta morale dhe kulturore,
humanitet.**



Gazetaria është...

...luftim i të gjitha llojeve të diskriminimit, kufizimeve, përjashtueshmërisë, mostolerancës, padrejtësive, presioneve, dhunës...

...një nga profesionet më me përgjegjësi, më finsike, por edhe më të rënda.



Kodeksi etik i Asociacionit Gazetaresk të Norvegjisë

Kodeks etik i standardeve dhe praktikave për mediat – shtypin, radion, televizionin dhe internet publikimet të Norwegian Press Association. Është e domosdoshme që çdo redaktor, gazetar dhe anëtar i redaksisë të njoftohet me këto standarde etike të gazetarisë dhe ta bazojë punën e tij mbi këtë Kodeks të etikës. Ky kodeks e përfshin procesin e gjithmbarshëm gazetaresk – grumbullimin e informacioneve, hulumtimin dhe publikimin.

1. ROLI I SHTYPIT NË SHOQËRI

1.1. Liria e të shprehurit, liria e informimit dhe liria e metodave janë shtyllat kryesore të demokracisë. Liria dhe pavarësia e gazetarisë dhe mediave janë mes bazave më të rëndësishme të një shoqërie demokratike.

1.2. Gazetaria ka rol dhe funksion kyç në informimin për ngjarjet dhe lëvizjet vijuese, debatet dhe komentet kritike për këto ngjarje. Me këtë rast, përgjegjësi e veçantë e

gazetarisë është që të mundësojë pikëpamje të ndryshme që disa çështje të jenë saktë të shprehura dhe të transmetuara.

1.3. Gazetaria duhet ta mbrojë lirinë e të shprehurit, lirinë e informimit dhe parimin e qasjes së lirë deri te burimet e informacioneve dhe deri te dokumentet zyrtare. Gazetarët dhe mediat nuk guxojnë të lëshojnë pe para çfarëdo qoftë presioni, prej ngado që të vijë, qëllimi i të cilëve është që të pengohen debatet e hapura, qarkullimi i lirë i informatave dhe qasja e lirë deri te burimet. Marrëveshjet për raportim ekskluziv nga ndonjë ngjarje nuk duhet ta përjashtojnë dhe ta parandalojnë raportimin e pavarur të gazetarëve.

1.4. E drejtë dhe obligim i gazetarisë është që të publikojë informacione për atë se çka ndodh në shoqëri, t'i locojë dhe t'i zbulojë çështjet të cilat do të duhet t'i nënshtrohen kritikës. Obligim i gazetarisë është që t'i mënjanojë mëdyshjet dhe kritikën për atë se si mediat e realizojnë rolin e tyre.

1.5. Detyrim i gazetarëve dhe i mediave është që t'i mbrojnë individët dhe grupet nga padrejtësitë dhe diskriminimi, të kryera nga ana e organeve publike dhe institucioneve, nga firma private, ose kushdo qoftë tjetër.

2. INTEGRITETI DHE PËRGJEGJËSIA

2.1. Kryeredaktori mban përgjegjësi ligjore, personale dhe të plotë për materialet të publikuara në media, pa marrë parasysh se në cilën formë janë publikuar.

2.2. Çdo kolegji redaktues dhe çdokush nga të punësuarit në media duhet ta mbrojë integritetin dhe kredibilitetin e tij, me qëllim që të jenë të lirë, të veprojnë në mënyrë të pavarur nga cilëndo individë apo grupe, për shkaqe ideologjike, ekonomike ose të tjera, ndoshta do të duhet të kryejnë ndikim mbi orientimin redaktues.

2.3. Anëtarët e redaksisë nuk guxojnë të pranojnë porosi ose obligime, mbështetje financiare ose ndikime të tjera, me të cilat krijohet konflikt interesash në lidhje me detyrën e tyre redaktuese. Nuk guxohet të ketë lëshime në punët, të cilat do të mund të ndikojnë mbi kredibilitetin e gazetarëve dhe të redaksisë.

2.4. Anëtarët e redaksisë nuk guxojnë ta shfrytëzojnë pozicionin e tyre për fitim të dobisë personale.

2.5. Një redaktor ose anëtar i redaksisë nuk guxon të urdhërojë që të shkruhet ose të bëhet diçka që është në kundërshtim me bindjen e tij ose të saj.

2.6. Duhet të ekzistojë një distinkcion i qartë mes reklamave dhe orientimit redaktues dhe të hidhet poshtë çdo përpjekje që kjo ndarje të priset ose të ndërpritet. Reklammat të cilat kanë intencë që ta imitojnë ose ta shfrytëzojnë orientimin redaktues, duhet të përjashtohen, sepse mund ta minojnë besimin në integritetin redaktues dhe në pavarësinë e medias.

2.7. Kurrë nuk guxohet të premtohet shërbim redaktues për të marrë reklama. Teksti/kronika duhet të publikohet si rezultat i mendimit dhe përcaktimit të redaksisë. Duhet të shihet qartë se me rëndësi vitale është dallimi mes gazetarisë dhe komunikimit komercial, si dhe se ajo të mbahet edhe krahas vendosjes së linqeve në ueb-faqen ose në lloje të tjera të kontakteve.

2.8. Shkelje e rregullave të mirësjelljes është nëse lejohet që sponsorizimi të ushtrojë presion ose ndikim mbi përcaktimin redaktues, mbi përmbajtjet dhe mënyrën e prezentimit të tyre.

2.9. Një anëtar i redaksisë nuk mund të pranohet detyra nga askush, përveç nga redaktorët në redaksi.

3. KODEKSI GAZETARESK DHE RAPORTET ME BURIMET

3.1. Burimi i informacionit, sipas rregullit, duhet të identifikohet, përveç nëse kjo mund të ndikojë mbi sigurinë e burimit ose për shkak të kujdesit për një palë të tretë.

3.2. Duhet qenë kritik gjatë zgjedhjes së burimit dhe duhet verifikuar nëse janë të sakta informacionet e parashtruara. Praktikë e mirë është që të insistohet gjatë zgjedhjes së burimeve që ato të jenë të llojllojshme dhe relevante. Nëse shfrytëzohen burime anonime ose gazetarit/medias i ofrohet ekskluzivitet, duhet të zbatohen kritere jashtëzakonisht të rrepta për verifikime dhe për vlerësim kritik të burimeve. Kujdes i veçantë nevojitet kur punohet me informacione të burimeve të ndryshme, me informacione nga burime të cilat vetë ofrojnë ekskluzivitet, si dhe me informacione të siguruara nga burime në zëvendësim për kompensim.

3.3. Nevojitet sjellje e jashtëzakonshme dhe sqarim i kushteve gjatë publikimit të intervistave. Qasja e njëjtë është e nevojshme edhe gjatë zbatimit dhe publikimit të hulumtimit.

3.4. Gazetarët i mbrojnë burimet e informa-

cioneve. Mbrojtja e burimeve është parim kryesor në shoqërinë e lirë, parakusht kyç që gazetaria të mundet në mënyrë cilësore t'i plotësojë obligimet e veta ndaj shoqërisë dhe të sigurojë qasje deri te informacionet me rëndësi thelbësore.

3.5. Nuk guxohet të zbulohet emri i njeriut i cili siguron informacione të besueshme, përveç me pajtueshmëri eksplicite të dhënë nga ana e tij.

3.6. Duke i respektuar burimet e informimit dhe pavarësinë e gazetarisë, materialet e papublikuara , sipas rregullit, nuk duhet t'u zbulohen personave të tretë.

3.7. Detyrim i gazetarëve gjatë raportimit është që opinionet e drejtpërdrejta t'i publikojnë në citate. Konstatimet direkte/citatet duhet të jenë të sakta.

3.8. Ndryshimet eventuale në deklaratën e dhënë duhet të jenë të kufizuara vetëm në korrigjime të gabimeve faktike. Përveç organit redaktues, askush nuk mund të intervenojë në redaktimin ose prezentimin e përmbajtjeve.

3.9. Hulumtimet gazetareske duhet të zbatohen në mënyrë të kujdesshme. Veçanërisht duhet pasur kujdes me njerëz nga të cilët nuk mund të pritët të jenë koshientë për atë se rrëfimet e tyre mund të kenë pasoja. Asn-

jëherë nuk mund të keqpërdoren emocionet ose ndjenjat e njerëzve, mosdituria e tyre ose paaftësia për të gjykuar. Nuk guxohet të harrohet se njerëzit në gjendje shoku ose pkiëllimi janë shumë më të ndjeshëm.

3.10. Kamera e fshehtë/mikrofoni ose identiteti i rremë mund të shfrytëzohet vetëm në rrethana speciale. Këto mjete mund të shfrytëzohen vetëm nëse metodat e këtilla janë mënyra e vetme e mundur që të zbulohen raste që janë me rëndësi esenciale për shoqërinë.

3.11. Gazetarët/redaksitë sipas rregullit nuk u paguajnë burimeve ose bashkëbiseduesve për informacionet. Gjatë zbatimit selektiv të pagesës ekziston mundësia që lajmet të jenë të pasakta. Është e palejueshme në praktikë që të vendoset sistem i pagesës që të joshen njerëzit, sepse të njëjtët mund t'i vë në sprovë, edhe atë për dy arsye: për shkak të shkeljes së privatësisë së të tjerëve ose zbulimit të informacioneve të ndjeshme personale.

4. RREGULLAT PËR PUBLIKIM

4.1. Në mënyrë të paanshme dhe të drejtë, me vëmendje dhe seriozisht duhet të përcak-

tohen përmbajtja dhe prezentimi.

4.2. Qartë duhet të kufizohet çka janë faktet dhe informacionet, e çka është komenti (i autorit).

4.3. Gjithnjë duhet të respektohet integriteti i personit, identiteti i tij, privatësia, raca, kombësia dhe feja. Asnjëherë nuk duhet të shkruhet për aspekte personale ose private, nëse ato janë jorelevante.

4.4. Duhet qenë të sigurt se titulli, hyrja dhe lidi janë në përputhje dhe rrjedhin nga ajo që përmban teksti. Në përputhje me praktikën e mirësjelljes është që të theksohet burimi, nëse informacioni është marrë nga një media tjetër.

4.5. Në mënyrë të veçantë duhet pasur kujdes për prezumpcionin e pafajësisë gjatë raportimit për ngjarje të ndërlidhura me kriminalitet ose gjatë raportimit nga gjykimi. Duhet të jetë e qartë se për çdokënd, pa marrë parasysh nëse ka dyshim të justifikuar, nëse është parashtruar kallëzim ose aktakuzë, faji vërtetohet vetëm me vendim gjyqësor të plotëfuqishëm. Në përputhje me praktikën e mirë është që të publikohet vendimi final gjyqësor për procedura për të cilat është shkruar më herët.

4.6. Kur raportohet për fatkeqësi ose për kriminalitet, gjithmonë duhet pasur ku-

jdes se si kjo mund të ndikojë mbi viktimat dhe më të afërmit e tyre. Nuk publikohet identiteti i viktimave ose i personave të zhdukur, po qe se paraprakisht nuk janë njoftuar më të afërmit. Duhet të tregohet respekt ndaj njerëzve të cilët janë të pikëlluar ose në gjendje shoku.

4.7. Me kujdes duhet të publikohen dhe të përdoren emra, fotografi dhe shenja të tjera të identifikimit të personave, të cilët janë të ndërlidhur me vepra kontestuese ose ndëshkuese. Nevojitet vëmendje e veçantë kur bëhet fjalë për raste në fazë të hershme të hetimit, për delikuentë minorene, si dhe për raste në të cilat identifikimi mund të shkaktojë pasoja të padëshirueshme ndaj palës së tretë. Identifikimi mund të jetë i bazuar dhe legjitim vetëm kur ka nevojë për një informacion të tillë. Legjitime është, për shembull, nëse identifikohet dikush kur ka rrezik të drejtpërdrejtë nga sulmi mbi persona të pafuqishëm, në rast të rrezikut serioz që të përsëritet krimi, nëse identiteti ose pozicioni shoqëror janë në mënyrë evidente relevantë për rastin ose kur identifikimi mbron të pafajshëm nga dyshimi i paarsyeshëm.

4.8. Gjatë informimit për fëmijë, praktikë e sjelljes së mirë është që, në çdo rast individu-

al, mediat të përqendrohen në implikimet të cilat do të mund t'i shkaktojnë. Kjo vlen edhe në rastet kur personi përgjegjës ose prindi, dakordohet për publicitet. Rregull është që identiteti i fëmijëve të mos publikohet në raporte për kontestet familjare, në raste që janë lëndë e shqyrtimit nga ana e pushtetit, ose gjatë përkujdesjes nga ana e gjykatave.

4.9. Kujdes i veçantë nevojitet gjatë raportimit për vetëvrasje ose vrasje në tentativë. Raportimit duhet të përmbajë vetëm informacione të përgjithshme, të domosdoshme. Duhet të shmanget përshkrimi i mënyrës ose disa çështje të tjera të cilat mund të kontribuojnë për provokim të mëtutjeshëm të aksioneve vetëvrasëse.

4.10. Gjatë shfrytëzimit të fotografive në cilindo kontekst tjetër jashtë origjinalit, duhet pasur shumë kujdes.

4.11. Duhet të mbrohet kredibiliteti i fotografisë gazetareske. Po qe se fotot shfrytëzohen nga dokumentacioni, kjo nuk guxon të jetë në mënyrë me të cilin krijohet përshtypje e gabuar. Manipulimi me fotografi mund të pranohet vetëm si ilustrim, nëse është e qartë se ajo është fotografi kolazh.

4.12. Publikimi i fotografive duhet të harmonizohet me kërkesat për vëmendje që zbatohen gjatë prezantimit me shkrim ose

me gojë.

4.13. Informacionet e pasakta duhet të rregullohen, ndërsa kur ka kërkesë për ndjesë, kjo duhet të jepet/publikohet sa më shpejt që është e mundur.

4.14. Atyre të cilët u janë nënshtruar akuzave të rënda duhet, nëse ajo është e mundur, t'u mundësohet përgjigje simultane në lidhje me informacionet faktike. Debatet, kritikak dhe publikimi i lajmeve, nuk guxon të pengohet nga palët, të cilat nuk janë të gatshme të japin komente ose të marrin pjesë në debat.

4.15. Ata të cilët kanë qenë objekt sulmi, duhet të kenë mundësi të përgjigjen sa më shpejt që të jetë e mundur, përveç nëse sulmi dhe kritikak janë pjesë e shkëmbimit të mendimeve që janë në rrjedhë. Çdo përgjigje duhet të jetë me gjatësi të duhur, në relacion me temën dhe në formë adekuate. Përgjigjja mund të refuzohet, nëse pala për të cilën bëhet fjalë e hedh poshtë, pa arsytetime objektive, ofertën për prezantim të vërejtjeve të veta për çështjen e njëjtë. Përgjigjet dhe pjesëmarrja në debat nuk duhet të jenë zë shoqëruara me koment polemik redaktues.

4.16. Duhet mbajtur llogari për pasojat që mund t'i shkaktojnë treguesit digjitalë dhe linqet, nëse mediat e këtilla elektronike nuk

janë në pajtueshmëri me Kodeksin etik. Duhet mbajtur llogari që linqet drejt medieve ose publikimeve të tjera të jenë qartë të shënuara. Praktikë e mirësjelljes është që të njoftohen shfrytëzuesit e serviseve interaktive për profilin e publikimit, si dhe për kushtet nën të cilat mund ta shfrytëzojnë.

4.17. Ekipi redaktues duhet të sigurojë që bisedat digjitale të mos mund të rirregullohen dhe kjo duhet t'u lihet në mënyrë të qartë atyre që kanë qasje në faqet. Ekipi redaktues ka përgjegjësi të veçantë për menjanim të shpejtë të pjesëve të cilat nuk janë në pajtim me Kodeksin etik.

Oslo, nëntor, viti 2007

Falënderojmë Asociacionin Gazetaresk të Norvegjisë, i cila u dakordua që Kodeksi i tyre etik të shtypet në Doracakun.





Gazetari...

...gjithmonë shkruan për lexuesin, shikuesin, dëgjuesin, për “njeriun e rëndomtë”. Bashkë me të gjurmon pas së vërtetës, lufton për të, zbulon hapësira të reja të lirive dhe të drejtave të njeriut.




...kurrnjëherë s’guxon ta nënçmojë intelektin e “njeriut të rëndomtë” duke shkruar të pavërteta, gjysmë të vërteta, duke fshehur faktet, duke mbajtur vetëm njërin anë, me çka devalvohen gazetaria si profesion dhe integriteti personal. E vërteta gjithnjë, megjithëse zakonisht mundimshëm dhe ngadalë, del në shesh.

Gazetari...

...i cili zbulon gabime, lëshime dhe jokonsekuencë, është i padëshiruar nga qendrat e fuqisë politike dhe të biznesit, por ato kanë respekt për të dhe tentojnë ta vënë nën kontroll të vetin.

...në garën e përditshme të mundimshme me ngjarjet dhe kohën, mund të hyjë në rutinë, mund të gabojë dhe gabon. Askush s'është mbinjeri. Por, gazetari nuk guxon t'i lejojë vetes mosrespektim të standardeve profesionale dhe normave etike, Në të kundërtën, vendimi më i ndershëm i tij do të ishte që ta braktisë gazetarinë, për të mirën e profesionit dhe të vetvetes.



KODEKSI I GAZETARËVE TË MAQEDONISË

I hartuar dhe miratuar nga Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë dhe dokument obligues, jo vetëm për anëtarët e saj, por edhe për të gjithë gazetarët dhe punëtorët medialë

PARIMET E SJELLJES

- Liria e mediave është e drejtë e pakontestueshme
- Detyra themelore e gazetarëve është respektimi i së vërtetës dhe së drejtës së opinionit të jetë i informuar, në përputhje me nenin 16 të kushtetutës së Republikës së Maqedonisë.
- Roli i gazetarëve është shpërndarja e informatave, ideve dhe mendimeve dhe e drejta për të komentuar. Duke respektuar vlerat etike dhe standardet profesionale në transmetimin e informatave, gazetarët duhet të jenë të ndershëm, objektivë dhe të saktë.

- E drejtë dhe detyrë e e gazetarëve është që të përpiqen të parandalojnë censurën dhe shtrëmbërimin e informatave.
- Duke përcjellë rolin e tyre në ndërtimin e demokracisë dhe shoqërisë qytetare, gazetarët do të mbrojnë të drejtat e njeriut, dinjitetin dhe lirinë, do të respektojnë pluralizmin e ideve dhe qëndrimeve, do të kontribuojnë në forcimin e shtetit të së drejtës dhe në kontrollimin e pushtetit dhe subjekteve tjera të jetës publike.

DUKE U BAZUAR NË KËTO PARIME DHE VLERA ETIKE

- 1.** Gazetari ka të drejtë për qasje të lirë deri të gjitha burimet e informimit, të cilat janë në interes publik. Gazetari duhet të botojë informata të vërteta e të konfirmuara dhe nuk do të fshehë të dhëna esenciale ose të falsifikojë dokumente. Në qoftë se informata nuk mund të konfirmohet, ose nëse bëhet fjalë për supozim, rrespektivisht spekulim, kjo gjë duhet cekur dhe botuar. Saktësia e informatës duhet vërtetuar aq sa është e mundur.
- 2.** Nëse gazetari pa arsye pengohet që të marrë informatën e kërkuar, ai ka të

drejtë që për këtë të informojë opinionin.

3. Gazetari do të tentojë që të sigurohet e drejta për korrigjim, demant dhe përgjigje, në ato raste kur vërtetohet josaktësia e informatës.

4. Gazetari do të cekë burimin e informatave, mirëpo, nese burimi kërkon që të mbetet anonim, gazetari do ta mbrojë atë.

5. Gazetari do të respektojë ligjet në shtet, mirëpo nuk do të publikojë ose fshehë asgjë që është në kundërshtim me interesin publik.

6. Gazetari nuk guxon të shfrytëzojë mediumin për publikimin ose fshehjen e informatave për përfitimin e të mirave për vetveten. Rryshfeti, korrupsioni dhe reketi janë gjëra të papërputhshme me profesionin e gazetarit. Nuk guxon të lejohet që reklamimi dhe motivet tjera komerciale të kenë influencë mbi lirinë e informimit. Duhet pasur distinkcion mes reklamimit dhe tekstit gazetaresk me ilustrim.

7. Gazetari duhet të respektojë jetën private të personit, përveç në raste kur kjo bie në kundërshtim me interesin publik. Gazetari e ka për detyrë të respektojë

dhimbjen dhe zinë personale.

8. Mënyra e informimit në rastet e fat-keqësive, katastrofave natyrore, luftërave, tragjediave familjare, sëmundjeve, proceseve gjyqësore duhet të jetë e liruar nga senzacionalizmi. Në proceset gjyqësore duhet të respektohet parimi i pafajësisë, të raportohet për të gjitha palët e përfshira në mosmarrëveshje dhe të mos jepen sygjerime lidhur me vendimin.

9. Gazetari nuk duhet të bëjë intervista ose të fotografojë fëmijë nën 16 vjeç pa pëlqimin e prindërve ose tutorëve, me përjashtim të rasteve kur një gjë e tillë nuk ka të bëjë me të drejtat e fëmijës.

Kjo vlen po ashtu për personat me nevoja speciale, të cilët nuk janë në mundësi që të gjykojnë me vetëdijen e tyre.

10. Gazetari nuk ka për të krijuar ose përpunuar me vetëdije informata, të cilat i kërcënojnë të drejtat ose liritë e njeriut, nuk ka për të folur me gjuhën e urrejtjes dhe nuk do të nxisë dhunë ose diskriminim mbi çfarëdo lloj baze (kombëtare, fetare, racore, gjinore, shoqërore, gjuhësore, politike, orientimi seksual...)

11. Gazetari do t'u përmbahet standardeve të pranuarra shoqërore që kanë të bëjnë me dinjitetin dhe respektimin e

dallimeve etnike, kulturore dhe religjioze në Maqedoni.

12. Bërja e plagiateve është e palejueshme. Citatet nuk duhet të shfrytëzohen pa miratimin e burimit ose autorit.

13. Gazetarët duhet të bëjnë dallim ndërmjet fakteve dhe mendimeve, ndërmjet lajmit dhe komenteve.

14. Raportimi për proceset politike, veçanërisht zgjedhjet, duhet të jetë i paanshëm dhe i balancuar. Gazetari duhet të sigurojë distancë profesionale prej subjekteve politike.

15. Gazetari duhet ta kultivojë kulturën e të folurit dhe etikën. Komunikimi i pasjellshëm me opinionin nuk ka të bëjë aspak me profesionin e gazetarit.

16. Gazetari do ta ruajë prestigjin dhe dinjitetin e profesionit të tij, do ta nxisë solidaritetin reciprok dhe pluralizmin e mendimeve dhe nuk do ta përdorë mediumin e tij për larjen e hesapeve me persona të ndryshëm përfshirë këtu edhe kolegët e tij.

17. Gazetari ka të drejtë të refuzojë urdhërat për punë në qoftë se një gjë e tillë është në kundërshtim me parimet e këtij Kodeksi.

RREGULLA PËRMBLEDHËSE

- Gazetarët që punojnë në përputhje me këtë Kodeks e gëzojnë përkrahjen e mediave të tyre dhe të organizatave të tyre profesionale.
- Në përputhje me ligjet e Republikës së Maqedonisë, gazetarët do ta pranojnë gjykimin profesional vetëm prej kolegëve të tyre dhe do të jenë jashtë ndikimeve politike dhe ndikimeve të tjera.
- Për respektimin e parimeve të këtij Kodeksi kujdeset Këshilli i Nderit i Shoqatës së Gazetarëve të Maqedonisë.

Shkup, nëntor 2001

GAZETARËT KUNDËR KORRUPSIONIT

Shtojcë e Kodeksit të Gazetarëve të Maqedonisë

- Çdo dhuratë apo shërbim që mund të ndikojë mbi informimin objektiv, konsiderohet korrupsion.

- Çdo shfrytëzim i profesionit të gazetarisë, funksionit, autorizimit publik dhe obligimit dhe pozitës zyrtare, për krijimin e çfarëdo qoftë përfitimi për vete apo për një subjekt tjetër, konsiderohet korrupsion në gazetari.

- Si burime të mundshme të korrupsionit konsiderohen: bartësit e funksioneve publike, funksionarë të zgjedhur dhe të emëruar, biznesmenë, parti politike, organizata arsimore, shëndetësore, fetare, sportive dhe kulturore, organizata qeveritare dhe joqeveritare, shtëpi mediatike dhe individë.

- Korrupsion i drejtpërdrejtë konsiderohet dhënia, marrja dhe nxjerrja me kërcënim e fitimit joligjor material dhe tjetër për realizim të përfitimit të gaze-

tarit apo medias.

- Korrupsion indirekt (i fshehur/i tërthortë) llogaritet: Organizimi i udhëtimeve, seminareve, këshillimeve; Protezhimi i gazetarëve dhe redaksive të caktuara si shoqërues të delegacioneve zyrtare, si dhe dhënia e shërbimeve dhe mjeteve me kushte të privileguara me qëllim të përfitimit të gazetarëve për heshtjen e fakteve relevante për publikun, si dhe për shkrime pozitive dhe afirmative.

- Nxjerrja me kërcënim e fitimit material dhe jomaterial nga ana e gazetarit me kërcënim për të botuar apo jo ndonjë informatë të caktuar, e cila mund t'i shkaktojë dëm një subjekti të caktuar, gjithashtu konsiderohet korrupsion. Për zhdjekjen e korrupsionit në profesionin e vet, gazetarët e Maqedonisë përpiqen për parimet në vijim:

- Esnafi i gazetarëve i kundërshton përpjekjet për ryshfet dhe korrupsion të kolegëve të vet dhe publikisht do t'i paraqesë rastet e tilla, në rast se ndodhin.

- Lufton për çrrënjosjen e korrupsionit në radhët e veta.

- E konsideron si të mospërputhshme punën e gazetarit me çfarëdo angazhimi politik.

- Përpiqet për pengimin e diskriminimit të organeve shtetërore ndaj mediave.

- Përpiqet për transparencë të pronësisë dhe punës financiare të mediave.

- Insiston për zbatim konsekuent të Ligjit për qasje të lirë deri te informatat me karakter publik.

- Bashkëpunon me organizata dhe institucione relevante, me media, me sektorin joqeveritar dhe privat, ekspertë të pavarur të vendit dhe të huaj dhe me bashkësinë ndërkombëtare.

Janar 2009

INTEGRITETI I GAZETARIT

Gazetarët e kanë për detyrë që të mbeten të veçuar dhe në distancë nga ata që e kanë fuqinë.

Obligim i gazetarëve është që ta humtojnë punën e organeve ekzekutive, të kërkojnë përgjegjësi nga ta, por këtë mund ta bëjnë vetëm në rast se kanë integritet.

Gazetarët duhet të kenë përgjegjësi para publikut, njashtu siç poltiikanët duhet të kenë përgjegjësi para atyre të cilët i kanë zgjedhur.

Në të kundërtën kemi të ashtuquajtur gazetarë, të kompromituar nga politika dhe politikanët, roli i të cilëve mbetet në nivelin e propaganduesve (PR) të tyre ose të zëdhënësve të rëndomtë.

Gazetarët pa integritet publikut ia pamundësojnë qasjen te informatat, ndërsa shoqëria mbetet pa informatat e domsdoshme për të funksionuar në mënyrë normale dhe korrekte

A 3D rendered metallic hand, possibly a robotic or mechanical one, is shown in the process of breaking through a surface. The hand is highly reflective and detailed, with visible joints and segments. The surface it is breaking through is fragmented into several pieces, some of which are flying away from the point of impact. In the center of the broken surface, the word "PRESS" is written in a bold, italicized, sans-serif font. The overall scene is set against a plain white background, emphasizing the metallic textures and the dynamic action of the hand breaking through the surface.

PRESS

TIPET E GAZETARËVE

- Organizata Media Ideas International nga Britanie e Madhe është themeluar nga Dejvid Bruer, gazetar dhe redaktor për shumë vite i temave politike në BBC, konsultant në CNN dhe në Al Xhezaira. Vitet e fundit punon konsultant për strategji mediale pothuajse në mbarë botën, sidomos në vendet në tranzicion dhe në periudha post-konflikte. Në bazë të përvojës definojnë shtatë tipe karakteristike të gazetarëve, ndër të cilët edhe kategorinë e Gazetarit të Vërtetë.

GJAHTARI: Pa u lodhur i përcjell politikanët. Ndjek çdo gjurmë. Ky gazetar asnjëherë nuk dorëzohet derisa nuk e fiton gjahun e vet. Ai ka fuqi udhëheqëse dhe nuk do t'u besojë politikanëve, madje as kur ata e flasin të vërtetën. Por, gjahtarit shpesh mund t'i mungojë objektiviteti dhe këndvështrimi i gjerë. Kontributi i tij për qartësimin e të kuptuarit nga ana e publikut është në pikëpyetje.

AKTIVISTI: I përkushtuar në kauzën e tij, do të luftojë me çdo politikan që është kundër saj dhe do ta mbështesë atë që dakordohet me të njëjtën. Ky gazetar mund të udhëhiqet nga ndonjë njëmendësi dhe të kufizohet vetëm në një dimension. Për të është vështirë që të gjendet baraspeshë, Nuk arrin ta vlerësojë perspektivën e ndryshme dhe të ofrojë balanc, shpesh edhe për arsye se balanci mund të ndikojë mbi konceptin të cilin që në fillim ka dashur ta realizojë. Aktivisti kënaqet kur perceptohet si martir dhe shpesh rrezikon që ai të shndërrohet në storje, në vend që ta udhëheqë atë dhe ta mbulojë.

MIKU: Bëhet i afërt me politikanët dhe rrallë herë e sjell pozicionin e tyre në pikëpyetje. Shpesh këmbëngul se politikasi ka të drejtë, pa marrë parasysh faktet që flasin për të kundërtën. Do t'i bëjë shërbim politikanit, por do të ketë kufij – zakonisht kur të shohë se mund të zbulohet. Ky gazetar gjithmonë është i gatshëm ta shtrijë dorën, nëse vlerëson se mbulimi i rrëfimit mund të jetë i favorshëm për të dhe për politikanin. Gazetari mik lëviz si fryn era dhe është i lehtë për manipulim.

I POSEDUARI: Ai është “prone” e politikanit dhe varet nga ai për shkak të kompromiseve të bëra më pare, apo afërsisë së tepruar. Integritetin e vet gazetaresk me siguri e ka humbur në zhvillimin e hershëm. Mund të pritët prej tij që të publikojë çfarëdo qoftë sipas dëshirës së politikanit, pa bërë pyetje. Ky gazetar është vetëm pak më shumë se një anëtar vullnetar i ekipit për marrëdhënie me opinionin të politikanit të njëjtë. Ai kënaqet duke u lavdëruar me emrat e personave të njohur dhe afërsinë me personat me ndikim.

ANËTARI I PARTISË: Bën gjithçka që ta fshehë anëtarësinë e vet, por megjithatë e tregon atë me tonin tij, përzgjedhjen e temave dhe aftësinë (ose paaftësinë) e tij në parashtrimin e pyetjeve hulumtuese. Ky gazetar do të shpenzojë shumë kohë në nxirjen e qëndrimeve politike të atyre me të cilët nuk pajtohet. Zakonisht do ta njihni sipas entuziazmit për të imponuar një rrëfim, të cilin gazetarë të tjerë më pak të komprometuar fare nuk e shohin se ekziston. Ai do ta mbrojë zgjedhjen e këtillë përkundër çfarëdo mendimesh logjike.

KOMODI: Unë do ta ruaj shpinën ty, ti timen. Përse të zihemi kur që të dy mund

të jetojmë rehat dhe levërdishëm. Kush do ta dijë? Ky gazetar e shikon punën e vet si ekzistencë dhe detyrim vetëm gjatë orarit të punës, nga ora 9 deri në orën 5. Zakonisht kënaqet me verë dhe ushqim të mirë. Në dispozicion është për të gjitha partite për të hapur “afëra” dhe këtë e shikon si qëndrim të vetin korrekt, të paanshëm dhe të pavarur.

GAZETARI I VËRTETË: I lirë nga lidhjet partiake. Ka integritet dhe nuk mund të blihet. Ka pasion profesional, e kërkon të vërtetën, raporton në mënyrë të drejtë dhe korrekte dhe paraqet më shumë opinione, madje edhe kur të njëjtat mund ta dobësojnë konceptin e rrëfimit. Është i gatshëm të hulumtojë gjithçka që e ka për zemër. Askënd nuk e shikon jashtë kufijve të qëndrimit kritik. Ai është i reallë kur është fjala për natyrën e njeriut. Gazetari i vërtetë e kërkon të vërtetën.

INTEGRITETI, ETIKA PROFESIONALIZMI

Gazetari gjithmonë duhet të qëndrojë i pavarur nga interesat shtetërore dhe partiake.

Kurrë nuk mbështet publikisht asnjë organizatë, produkt, shërbim ose aktivitet.

Po qe se përmbajtja që e prodhoni imponon ndonjë agjendë, favorizon një pjesë nga shoqëria ose dëshiron të imponojë rezultat, kjo nuk është gazetari, por kopje e marrëdhënieve me publikun (PR) ose e propagandës së dikujt. Gazetaria e vërtetë bazohet mbi etikën redaktuese me të cilën duhet të jetë i plotësuar çdo gazetar. Bëni verifikim, përgjigjuni në pyetjet vijuese. Përsëriteni herë pas here këtë mini-test, sidomos nëse ndjeni se keni rënë në rutinë, stereotipe ose keni ndonjë problem. Dhjetë pyetje për etikën

1. Cili është qëllimi im si gazetar?
2. Cili është motivi im personal?
3. A mundem t'i kyçi /inkorporoj/ ata me opinionet e ndryshme dhe ide të kundërshtuara?
4. A mundem në masë të barabartë t'i kyçi /inkorporoj/, opinionet me të cilat unë nuk pajtohem?
5. Kush janë pronarët, cilat janë motivet e tyre?
6. Çka do të ndodhte sikur të ndërroheshin rolet? Si do të ndjehesha?
7. A guxoj që qëllimet të cilat do t'i zgjedhja unë t'i vendos në agjendë?
8. Cilat janë pasojat e mundshme të veprimave të mia – në afat të shkurtër dhe të gjatë?
9. Cilat janë alternativat e mia për ta maksimizuar përgjegjësinë time që ta tregoj të vërtetën dhe ta minimizoj dëmin?
10. A mundem ta justifikoj dhe ta mbroj mendimin tim dhe vendimet e mia para kolegëve të mi, para pronarëve dhe para opinionit?

Zoti Dejvid me dëshirë i bëri të kapshme këto përmbajtje për nevojat e Doracakut.

Në sajtin e tij <http://www.mediahelpingmedia.org> ka edhe më shumë tekste të rëndësishme dhe të dobishme për etikën, integritetin dhe profesionalitetin e gazetarit.


GAZETARËT, FUQIA, PRESIONET...



Gazetari është vazhdimisht i nënsh-truar presioneve të fshehura ose të hapura nga burime të cilat duan ta imponojnë të vërtetën e vet, t'i realizojnë vetëm qëllimet e veta personale.

Presionet janë më të shpeshta dhe më të fuqishme nga ana e pushtetit – shtetit dhe institucioneve të tij, qendrave të fuqisë - politike dhe të biznesit, si dhe individëve të lidhur me to, përfshirë edhe pronarët e medimeve.

Pushteti, pa përjashtim, nuk i do gazetarët, por dëshiron ta shfrytëzojë fuqinë e tyre. Gazetarët, pa përjashtim, nuk duhet ta duan pushtetin.



Pushteti dhe qendrat e fuqisë as i duan dhe as i çmojnë individët të cilët nëpër medime janë apologetë dhe përkrahës të tyrët të njëanshëm. Nuk i konsideron si gazetarë, por si nëpunës shtetërorë dhe shërbëtorë të vetët.



ZHANRET GAZETARESKE

Sipas rregullave të Deutsche Welle (DW)

Gazetaria është profesion dinamik me sfida vazhdimisht të reja, të ndryshme, të çdoditshme. Nuk ka dhe nuk mund të ketë receta të gatshme, ndërsa suksesi varet nga individi. Ka, megjithatë norma dhe rregulla themelore profesionale, praktikë e mirësjelljes, që duhet t'i njohë dhe zbatojë gazetari, i cili dëshiron të punojë me përgjegjësi dhe në mënyrë profesionale.

Në bazë të përvojave të Dojçe Veles në doracak janë vendosur rregullat kryesore që duhet t'i dijë dhe zbatojë çdo gazetar që dëshiron të jetë i suksesshëm, si dhe media që dëshiron të ketë ndikim dhe publik.

Kryesore është që oferta e lajmeve, raporteve, kronikave dhe formave të tjera më të larta gazetareske në çdo media, t'i përmbajë risitë më të rëndësishme dhe më aktuale të ditës, nga vendi dhe nga bota. Lajmet, si dhe format tjera gazetareske duhet të jenë të balancuara, të qarta dhe të kuptueshme për lexuesit, shikuesit ose dëgjuesit, të përmbajnë risi dhe të jenë të rëndësishme dhe interesante që ta tërheqin vëmendjen e publikut.

me gojë, është me rëndësi përsëritja e termave. Sinonimet janë vështirë të kuptueshme për dëgjuesit dhe shikuesit. Problematike janë edhe fjalët e huaja. Nëse nuk është i mundur përkthimi i drejtpërdrejtë, atëherë duhet të sqarohet me përkthim.

4. Lajmi nuk guxon të përmbajë koment të drejtpërdrejtë. Raporti i gazetarit ndaj ngjarjes ose temës për të cilën shkruan, sipas rregullit, shprehet përmes asaj se me cilin element e ka filluar lajmin, si dhe me strukturën e tij.

5. Gjatë shkrimit të lajmit shfrytëzohet hapësirë sa nevojitet që të kuptohet thelbi i lajmit, ngjarjes. Me rregull, varësisht nga media, lajmi nuk është më i gjatë se një minut ose 14-15 rreshta ose 150 fjalë tekst i shkruar. Lajmi, me rregull ka katër paragrafe, të ndara grafikisht. I pari – lidi – e shpreh kokën e lajmit, dy të ardhshmit më shumë e sqarojnë lajmin, ngjarjen. Paragrafi i fundit është bekgroundi – risqarim, përkujtim dhe ndërlidhje me ndonjë ngjarje të mëparshme ose të ngjashme. Përrjashtim është lajmi urgjent (breaking news), i cili më shpejt dhe më shkurt njofton për ngjarje të jashtëzakonshme politike, katastrofa natyrore, fat-keqësi të mëdha. Lajmi i parë mund të shkruhet në një ose në dy fjali dhe nuk duhet dhe nuk mundet t'i përmbajë të gjitha elementet.

besueshmëri. Kronikat pa tone origjinale janë përjashtim dhe ato duhet të jenë shumë të shkurtëra. Përveç of-toneve, raporti mund të përmbajë edhe atmosferë (atmo), për shembull zëra në sfond nga demonstratat para parlamentit. Of-tonet përmbajnë deklarata të rëndësishme (për shembull, pranim i rezultateve zgjedhore), qëndrime personale, interpretime ose sqarime (pse kanë dështuar zgjedhjet), argumente të ndryshme të ndërlidhura me temën, ndjenjë ose atmosferë (si i dështuari e ka pranuar rezultatin zgjedhor). Of-tonet duhet të përmbajnë deklarata dhe qëndrime të qarta, e jo të shfrytëzohen vetëm sa për të qenë.

•••••••••••••••••••• **ARTIKULLI ONLAJN**

Shpërhyje gazetareske relativisht e re, e cila në përmbajtje nuk dallon nga “klasiket”. Përparësia është se me shfrytëzimin e teknikave, artikulli bëhet i llojlojshëm dhe interesant. Tek artikujt onlajn në bazë duhet të shfrytëzohen fjali të shkurtëra. Nevojitet përdorimi edhe i mestitujve që lexuesi edhe më tej të jetë i animuar që të vazhdojë të lexojë.

Si gjatësi maksimale për këto lloj artikujsh rekomandohen më së shumti 65 rreshta, rreth 650 fjalë. Tekstet më të gjata duhet të përpunohen

istohet të merren informacione të qarta dhe mjaftueshëm të zgjeruara. Nga njëra anë intervista është formë e veçantë gazetareske. Nga ana tjetër, informacionet e marra mund të shfrytëzohen si lajme, raporte ose komente. Për të gjitha intervistat vlen: i pyeturi është personi kryesor. Rrëfimet e tij janë pjesa më e rëndësishme e intervistët. Gazetari që e zhvillon intervistën sillet si ndërmjetësues mes të intervistuarit dhe dëgjuesve, shikuesve ose lexuesve. Pyetjet e tij janë të shkurtëra, precize dhe zakonisht të orientuara drejt arritjes së qëllimit të intervistës. Ai duhet të jetë neutral dhe të përmbahet nga emocionet e mundshme që do të dilnin nga përgjigjet. Mendimi i tij nuk guxon të vijë në shprehje. Më me rëndësi është që praktikisht të mblidhen fakte, të kryhen hulumtime për temën dhe personin që intervistohet. Me këtë para se të fillojë intervista duhet të jetë e qartë deri ku janë “linjat e kuqe” dhe cili është qëllimi që duhet të arrihet. Gazetari duhet të mendojë se si do të arrijë bisedë interesante dhe të tendosur dhe çfarë konfliktesh mund të shkaktojë. Gazetari duhet të ruajë qëndrim të orientimit drejt thelbit, racionalitetit dhe kritikës. Nëse i intervistuari është ekstensiv, guxon ta ndërpresë, por kjo të jetë në mënyrë të sjellshme, që i intervistuari të detyrohet të flasë qartë. Intervista në formë të shkruar, të shtypur dhe në Internet, transmetohet me pyetjet në formë kursive, ndërsa

Zakonisht ndërrohen elementet skenike me përpunim të fakteve.

●●●●●●●●●● ● PASQYRA/BEKGRAUNDI

Bekgraurdi sjell më pak informacione gjithëpërfshirëse të njohura për tema qartë të projektuara dhe të zjedhura. Raporti i autorit është i orientuar drejt qenësore, i kuptueshëm dhe kritik. Ai e paraqet temën të nënrenditur sipas kontekstit. Bekgraurdi përmban fakte, rrëfime, qëndrime të pjesëmarrësve dhe ekspertëve. Ai jep pasqyrim me ndihmë të qëndrimeve të ndryshme, pa u vlerësuar ato. Autori i bekgraurdit mund të analizojë, por nuk guxon të komentojë.

●●●●●●●●●● ● MODERIMI UDHËHEQJA

Moderimi e çon dëgjuesin ose shikuesin drejt temës dhe përgjigjet në pyetjen: pse sot kjo kronikë është e rëndësishme? Ajo përmban drejtime të rëndësishme ose informacione që nuk i përmban vetë kronika. Moderimi – paralajmërimi, jep drejtime për kontekstin dhe relevancën për temën. Nuk guxon të jetë i stërmbushur me fakte. Drejtuesi nuk guxon të komentojë. Qëllimi kryesor është që të tërhiqet dëgjuesi ose shikuesi.

Paralajmërimi dhe fillimi i kronikës paraqesin tërësi dhe për këtë duhet të shmangen përsëritjet. Përdoret gjuhë e thjeshtë dhe e kuptueshme.

• • • • • • • • • • • • • • • • **TOKSHOU**

Në tokshou vjen në shprehje biseda publike për tema të rëndësishme. Është e rëndësishme që të ftuarit të kenë pikëvështrime të ndryshme ose qëndrime individuale për një temë të caktuar. Vendimtare për suksesin e një tokshou është që të ftuarit, qëndrimet e tyre gjatë debatit t'i transmetojnë në mënyrë dinamike dhe të argumentuar, madje edhe në mënyrë kontroverse dhe për këtë t'u sigurohet mundësia e vërtetë – në aspektin kohor dhe pa ndërprerje të panevojshme nga drejtuesi. Ai nuk guxon të lejojë që debati të shndërrohet në polemikë të pastër, as të pozicionohet në anën e ndonjërit nga palët.

• • **RAPORTI NDAJ VOKS POPULLIT (ZËRIT TË POPULLIT)**

Siç tregon edhe emri, voks populli janë zërat nga populli. Ato përdoren për qëndrim, respektivisht si opinion publik dhe paraqesin deklaratatë të shkurtëra nga persona “të prekur” ose “kalimtarë” dhe shfrytëzohen nga ana e reporterëve në kronikat e tyre për radio dhe TV që ta nënvizojnë autenticitetin e raportit. Është

me rëndësi që ato asnjëherë të mos trajtohen si
reprezentative, as të konsiderohen si sondazhe.
Është e rëndësishme, gjithashtu, që ato të jenë të
balancuara . Autori nuk guxon “zërin e popullit” ta
shfrytëzojë si mjet për opinion personal.

PËR PROJEKTIN

Doracaku për gazetarë është pjesë e projektit Më shumë se doracak, të cilin e realizon Civil – Qendra për Liri në bashkëpunim me Shoqatën e Gazetarëve të Maqedonisë, si dhe me përkrahjen e Media Helping Media nga Britanie e Madhe.

Projekti u financua nga Ambasada e Mbretërisë së Norvegjisë në Shkup.

Ky projekt është pjesë e Programit vjetor të Civil – Qendrës për Liri, i përkrahur nga Programi Civica Mobilitas, i financuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) dhe i implementuar nga Qendra për Zhvillim Institucional (CIRa).

Mendimet e shprehura këtu janë të autorit/ autorëve dhe jo domosdo i reflektojnë mendimet e donatorëve.

Botues: Civil – Qendra për Liri

Për Botuesin: Xhabir Memedi Deralla, Kryetar i Civil-it

Kryeredaktor: Risto Popovski

Zëvendës-kryeredaktor: Ilir Ajdini

Redaksia:

Josif Qurçiev, Sonja Eftovska, Biljana Zdravevska

Kontakte:

Civil – Qendër për Liri

Maksim Gorki, 31/1, 1000 Shkup, RM

<http://www.civil.org.mk>

<http://www.civil-link.blogspot.com>

civil.mk@gmail.com

02/5209176

DG: Archie PRESS

Shtypi: Autoprint T.A. - Shkup

Tirazhi: 1000 copë

CIP - Каталогизacija vo publikacija

Nacionalna i univerzitetska biblioteka „Св. Климент Охридски“, Скопје

070(035)

DORACAK gazetaresk / [kryeredaktor Risto Popovski]. - Shkup :

Civil, 2011. - 69 стр. : илустр. ; 21 см

ISBN 978-9989-2001-4-4

I. Popovski, Risto [главен уредник]

а) Новинарство-Прирачници

COBISS.MK-ID 89217802

